



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e VII-të të rregullt të punës për vitin 2019.

Seanca mbahet më 26.07.2019 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Për këtë seancë propozohet ky:

### RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Përgjithshëm për Komunën e Klinës për vitin 2018 (ref.Drejtori i FEZH),
5. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-qershor 2019 (ref.Drejtori i FEZH),
6. Informimi i Kuvendit me aktivitetet e KKSBB për gjashtëmuajorin e I-rë të vitit 2019.
7. Shqyrtimi i Procesverbalit të Takimit me qytetar për gjashtëmuajorin e I-rë të vitit 2019 të mbajtur nga Kryetari dhe rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa për Kuvend ,
8. Raporti për subvencione (ref. Drejtorja e KRS),
9. Formimi i Komisionit për hartimin e Draft ndryshimeve të Rregullores për ndarje të bursave për studentet e komunës së Klinës,
10. Formimi i komisionit për vlerësim të gjendjes socio-ekonomike të shfrytëzuesve të banesave sociale,
11. Inicimi i procedurës për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 dhe formimi i komisionit për hartimin e ndryshimeve të Rregullores.

01Nr. 06-30333- 2019  
Më 17.07 2019



Kryesuesi,  
Fadil Gashi